



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **61**

Prishtinë, më 26.3.2012, ora 10,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Daut Haradinaj, Etem Arifi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: Kryeministri i Kosovës Hashim Thaqi, zyrtar nga MMPH dhe Ministri, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (ICO-Piter Feit me bashkëpunëtor, KDI, OSBE, Ambasada Amerikane, Presidenca) dhe media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 22.3.2012,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Prizrenin,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.3.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 22.3.2012.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Prizrenin

Nait Hasani falënderoi të gjithë pjesëmarrësit që ishin në mbledhje të cilët kontribuan dhe ende kontribuojnë në përfundimin e punës së Komisionit rreth këtyre dy Projektligjeve.

Kryetari Nait Hasani filloi mbledhjen me konstatimin se në mbledhjen e kaluar nuk mund të thuhet se komisioni ka pas ndërhyrje apo presion nga Kryeministri dhe përfaqësuesi i ICO Piter Feit rreth Projektligjit për Hoçën, ngase Kryeministri dhe çdo kryeministër tjetër kanë drejtë në bashkëpunim me Komisionin, poashtu edhe të interesuar tjerë. **Liburn Aliu**, vazhdoi, në medie ka dhënë një deklaram të pamatur, mirëpo kjo është në kuadër të personalitetit që ai përfaqëson veten, dhe ka drejt të deklaroj si dëshiron vetë. **Liburn Aliu** kërkoi koment dhe kundërshtoi z. Hasani ngase si tha ai “në komision u muarëm vesh që KZM është vetëm për zonat e veçanta por jo edhe për fshatin, ajo nuk mund të ketë kompetenca rurale por vetëm kompetenca për trashëgimi kulturore, ndërsa pastaj pas pauzës doli tjetërqysh”. **Nait Hasani** rikujtoi z. Aliu se ka hequr dorë në Komision sa i përket shqyrtimit të Projektligjit për Prizrenin. **Liburn Aliu** pohoi se ashtu është por vetëm sa i përket punës në grupin punues, megjithatë ai lëshoi mbledhjen duke përsëritur vërejtjet e mëparshme që i ka thënë në komision se nuk është miratuar kërkesa për ekspert ndërkombëtar për shkak të ngutisë së dikujt.

Komisioni në vazhdim, fillimisht shqyrtoi çdo amendament veç e veç që janë sjellur deri tani, ndërsa në fazën e dytë ato u votuan si vijon :

Amendamenti 1

Neni 1, riformulohet :

Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për mbrojtjen, administrimin dhe zhvillimin bashkëkohorë të qëndrueshëm të Qendrës Historike të Prizrenit si pronë e trashëgimisë kulturore dhe historike në mbrojtje të përhershme dhe të klasifikuar si Zonë e veçantë e mbrojtur me vlera të interesit lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar.

Amendamenti 2

Neni 2 dhe Neni 3 riformulohen dhe bashkohen në një Nen si vijon (bëhet rirenditja i Neneve të radhës) :

Neni 2

Fushëveprimi dhe parimet e përgjithshme

1. Administrimi i Qendrës së mbrojtur historike të Prizrenit zhvillohet duke u bazuar në parimet e përgjithshme vijuese :

1.1 mbrojtja, ruajtja, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e karakteristikave tradicionale historike urbane të Qendrës së mbrojtur historike të Prizrenit bëhet sipas parametrave të elaboruar në nenet 5,6,7 dhe 8 në planin e konservimit, pjesë integrale e këtij ligji, Shtojca 1;

1.2 integrimi i Qendrës së mbrojtur historike të Prizrenit në të gjitha nivelet e planeve hapsinore e urbanistike zhvillimore të vendit;

1.3 rehabilitimi, restaurimi, adaptimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave, monumenteve dhe mjediseve të tyre rrethuese në përputhje me standarde profesionale për konservim dhe restaurim;

1.4 elaborimi i politikës dhe planit të menaxhimit të konservimit, me përcaktim të normave, detyrave dhe mënyrave të bashkëpunimit me autoritetet e trashëgimisë kulturore, autoritetet e planifikimit hapësinor dhe zhvillimor të vendit, autoritetet e qeverisjes komunale të Prizrenit dhe popullata;

1.5 përcaktimi i të drejtave dhe obligimeve të poseduesve të pronave të trashëgimisë kulturore në mbrojtje;

1.6 pjesmarrja në një proces transparent vendim marrjeje të palëve të ndryshme të interesit;

1.7 sigurimi i fondeve sistematike për restaurim dhe mirëmbajtje të Qendrës historike të Prizrenit duke përfshirë të gjitha elementet përbërëse të saj, përmes sigurimit të lehtësirave fiskale duke bërë stimulimin e zhvillimit ekonomik dhe përmirësimit e kushteve të jetesës.

2. Konservimi dhe mbrojtja e Qendrës Historike të Prizrenit bëhet në pajtim me parimet dhe standardet ndërkombëtare në pajtim me Ligjin e trashëgimisë kulturore, Ligjin për Planifikim Hapësinor dhe dokumente ndërkombëtare të UNESCO-s për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe traktatet e BE.

Amendamenti 3

Neni 4, në paragrafin 1.1 shprehja “të themeluar me këtë ligj” zëvendësohet me “**bazuar me këtë ligj**”, ndërsa në tekstin e mëtejshëm të nenit, në çdo pikë hiqet fjala “**nënkupton**” e cila zëvendësohet me shenjë (:) dy pika.

Amendamenti 4

Neni 4, nënparagrafi 1.7, në Nenin 16 dhe gjithkund në ligj, emertimi “**Komitet**” zëvendësohet me “**Këshill**”.

Amendamenti 5

Neni 5, riformulohet :

Qendra e mbrojtur historike e Prizrenit

1. Qendra e mbrojtur historike e Prizrenit me të gjitha elementet përbërëse të tij shtrihet në territorin me kufinj të përcaktuar në hartë ku përfshihet territori i kalasë, planin e konservimit dhe listën e parcelave kadastrale, pjesë integrale e këtij ligji, shtojca 1.
2. Qendra e mbrojtur historike e Prizrenit, si pronë e trashëgimisë kulturore në mbrojtje përfshihet në listën e trashëgimisë kulturore, në mbrojtje të përhershme të Republikës së Kosovës.
3. Rivlerësimi apo rishikimi i Qendrës së mbrojtur historike të Prizrenit me të gjitha elementet e saj bëhet nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor në bashkëpunim me institucionet kompetente të trashëgimisë kulturore, me kërkesën apo propozimet e parashtruara nga persona fizik dhe juridik, si në shtojcën 2 të këtij ligji me listën e monumenteve që gjenden në këtë shtojcë.

Amendamenti 6

Neni 6, në paragrafin 2 fjala “karakterin” zëvendësohet me “**karakteristikat**” si dhe në tërë tekstin e projektligjit.

Amendamenti 7

Neni 7 dhe 8 bashkohen dhe riformulohen si vijon :

Neni 7

Aktivitetet e kufizuara dhe të ndaluara në Qendrën historike të Prizrenit

Për zbatimin e nenit 6 të këtij ligji, me qëllim të mbrojtjes së autencitetit dhe integritetit të Qendrës historike të Prizrenit, kufizohen dhe ndalohen aktivitetet si në vijim:

1. Aktivitetet e kufizuara :

- 1.1. bashkimi i dy apo më shumë parcelave kadastrale në një njësi të vetme, përveç kur parcela është duke u kthyer në gjendjen e saj origjinale gjatë restaurimit, rindërtimit ose revitalizimit të ndërtesave tradicionale dhe monumentit që është nën mbrojtje.
- 1.2. vendosja e kiosqeve, tezgave, tavolinave dhe elementeve tjera montazhe, parkingjeve ose të ngjajshme që do të pengonte vizurat dhe qasje të lirshme në monument si dhe vendosja e kontejnerëve dhe shportave tjera për mbeturina para dhe në afërsi të monumentit.
- 1.3. muzika me zë më të lartë se 70 db, përveç gjatë ngjarjeve/organizimeve të natyrës publike, për të cilat mirret paraprakisht leja prej Komunës.
- 1.4. vendosja e reklamave të përhershme, shenjave private, dekorimeve apo elementeve penguese me sipërfaqe më të madhe se 1m² dhe pa pëlqimin e Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit.

2. Aktivitetet e ndaluara :

- 2.1. aktivitetet ndërtimore apo transformuese që rezultojnë me ngritjen e një objekti të vetëm në dy apo më shumë parcela kadastrale;
- 2.2. aktivitetet ndërtimore apo transformuese që do të rezultojnë në objekte me lartësi më të madhe se Përdhësë + 2 etazhe (P+2); apo lartësia e të cilëve, e matur prej nivelit të terrenit natyror deri në nivel të vijës së strehës, tejkalon 9.5m; apo lartësia e tërësishme e të cilëve, e matur prej nivelit të terrenit natyror duke përfshirë çatinë dhe çfarëdo vazhdim tjetër fizik në objekt, tejkalon 12.5m;
- 2.3. aktivitetet ndërtimore apo transformuese që do të rezultojnë me objekte ku sipërfaqja e përdhësës nuk do të tejkalojë 150m², me përjashtim të rasteve të veçanta të rindërtimit apo rifunksionalizimit të objekteve publike, duke e respektuar karakterin e Qendrës Historike, të cilat duhet të kalojnë po të njëjtat procedura të marrjes së lejes urbanistike nga Komuna dhe pëlqimit nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit;
- 2.4. aktivitetet që do të rezultojnë në ndryshimin permanent të morfologjisë natyrore të terrenit;
- 2.5. pompat e reja të derivateve të naftës si dhe ndërtimet industriale, fabrikat ose zhvillimet e ngjajshme përfshirë eksploatimin e burimeve minerale dhe furrënaltat;
- 2.6. aktivitetet e natyrës komerciale të cilat përfshijnë një sipërfaqe të hapësirës së brendshme më të madhe se 150m² duke përfshirë depot, punëtoritë mekanike, supermarketet dhe klubet e natës;
- 2.7. funksionimi i kazinove, bastoreve dhe veprimtarive tjera të lojrave të fatit;

Amendamenti 8

Neni 12, titulli riformulohet : “**Hulumtimet dhe gërmimet arkeologjike**” dhe në rreshtin e parë fjala “Gërmimet arkeologjike” zëvendësohet me “**Hulumtimet dhe gërmimet arkeologjike**”.

Amendamenti 9

Neni 14, paragrafi 2 fshihet.

Amendamenti 10

Neni 15, në paragrafin 2, në rreshtin e 4 fjala “dispozitat relevante” zëvendësohet me “ligjet”. Në vijim përkatësisht në fund fshihet “dhe fatkeqësive tjera”.

Amendamenti 11

Deputeti **Nait Hasani**- përkrahur nga Komisioni :

Neni 16, nënparagrafi 1.1 riformulohet : “**gjashtë (6) anëtarë të trashëgimisë kulturore, arkeologjisë, arkitekturës nga shoqëria civile në Prizren, që kanë përvojë në ruajtjen, zhvillimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore ;**”

Në Nenin 16 fshihen nënparagrafët me pikat si vijon :

1.2. tre (3) anëtarë nga shoqëria civile sipas nënparagrafit 1.1. të këtij neni, do të përzgjidhen:

1.2.1. një (1) anëtar përzgjidhet nga Bashkësia Islame;

1.2.2. një (1) anëtar përzgjidhet nga Kisha Ortodokse Serbe dhe

1.2.3. një (1) anëtar përzgjidhet nga Kisha Katolike;

1.3. së paku dy (2) prej anëtarëve nga shoqëria civile do të jenë ekspertë të njohur në fushën e trashëgimisë kulturore, me kualifikim apo përvojë profesionale në fushë të tillë. Preferencë do të kenë kandidatët që i përmbushin të dy kriteret;

Fshihet paragrafi 6 i Nenit 16 :

6. Asambleja Komunale emëron anëtarët e Komitetit të përzgjedhur nga Kisha Katolike, Bashkësia Islame dhe nga Kisha Ortodokse Serbe për këtë mandat.

Piter Feit lidhur me këtë amendament shprehu mendimin se nuk është mirë të hiqen dispozitat e lartcekura rreth përfaqësimit të komuniteteve, ngase ato lejohen me dokumentin bazë të Ahtisarit të cilët kanë drejt në pronën e tyre, nëse jo atëherë parashtrohet pyetja cili është qëllimi i këtij ligji nëse nuk epen drejtat fetare. **Nait Hasani** kundërshtoi duke cituar nenin e Kushtetutës që ka shpallë shtetin tonë laik, dhe shtoi se këto dispozita mbi përfaqësimin e komuniteteve nuk kanë nevojë të ekzistojnë. Ministri **Dardan Gashi** tha se Kisha, Xhamia etj nuk kanë fuqi shtetërore, ato i takojnë fuqisë civile dhe se ato kanë pronat e veta të cilat duhet ti mbrojnë në rast nevojë.

Amendamenti 12

Neni 16 paragrafi 10, fshihet fjalia në fund “konform UA të MAPL nr.2008/10”.

Ky amendament u miratua ngase me këtë ligj themelohet Këshilli.

Amendamenti 13

Neni 18, paragrafi 2, në rreshtin e dytë, pas fjalës “Prizrenit” shtohet “**sipas legjislacionit për trashëgiminë kulturore**”.

Përkrahet Amendamenti 3 nga Qeveria lidhur me nenin 18, të **fshihet paragrafi 4**.

Përkrahet Amendamenti 4 nga Qeveria, lidhur me nenin 18, riformulohet paragrafi 3 : “**Këshilli duhet të konsultohet me pronarin nëse prona e tij/saj preket nga kërkesa e projektit me qëllim që të sigurohet përputhshmëria me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi për pronën**”.

Amendamenti 14

Neni 20, riformulohet :

Neni 20 E drejta në ankesë (Moratoriumi)

1. Në qoftë se brenda 15 ditëve pas kërkesës për konsultime shtesë nuk arrihet marrëveshja, Drejtoria e urbanizimit lëshon lejen përkatëse ose e refuzon duke u bazuar në Planin e konservimit dhe ligjet në fuqi.

2. Leja e lëshuar apo e refuzuar nga Drejtoria e urbanizimit, i dërgohet paraqitësit të kërkesës, Institutit për mbrojtjen e monumenteve në Prizren dhe Këshillit për Trashëgimi Kulturore të Prizrenit.

3. Kundër lejes së Drejtorisë së urbanizimit sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të ushtrohet ankesë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Brenda 15 dite nga dita e pranimit të vendimit për refuzim të lejes.

4. Vendimin sipas ankesës e merr MMPH në konsultim me Ministrinë e Kulturës, Rinis dhe Sporteve dhe Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

5. Në përputhje me Ligjin për Zonat e veçanta të mbrojtura, kontestet që kanë të bëjnë me Kishën Ortodokse Serbe, do t’i referohen KZM-së përmes Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrisë së Kulturës Rinisë e Sportit, Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore dhe nëse është e nevojshme Gjykatës Kompetente.

Ky amendament u miratua me pajtimin e Komisionit dhe Qeverisë.

Amendamenti 15

Neni 23, pas nënparagrafit 1.1 shtohet një nënparagraf, tjerat rinumërohen, si vijon :

1.2 informimit të publikut mbi rëndësinë dhe statusin e mbrojtur të qendrës historike të Prizrenit.

Në nënparagrafin ekzistues 1.2 në fund “shquar shumetnike” zëvendësohet me fjalën “**pasur**”.

Paragrafi 2, në fund fshihet fjalia “**dhe Zyra e Qendrës Historike të Prizrenit, në mënyrë që ajo të miratohet**”.

Amendamenti 16

Neni 24, shtohet paragrafi i ri pas paragrafit 2, si vijon :

3. Komuna aplikon lehtësira fiskale për personat fizik dhe juridik brenda zonës së Qendrës Historike të Prizrenit, konform nenit 5 të Ligjit për Trashëgimin Kulturore.

Amendamenti 17

Neni 25, fshihet paragrafi 2, ndërsa në paragrafin 3 hiqet “nga Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës”.

Amendamenti 18

Përmirësime teknike me sugjerimin nga Qeveria :

Neni 1, paragrafi 2, në gjuhën angleze, në rreshtin e parë, fjala “preservation” të shkruhet “preservation”.

Neni 7, nënparagrafi 1.4 në rreshtin e 4 fjala “nuk do të tejkaloi” zëvendësohet me “tejkalon”.

Shtojca 2, lista e monumenteve, është korrigjuar në tre gjuhët dhe duhet ti bashkëngjitet Projektligjit sipas shkresës nga Qeveria dt.13.01.2012.

Amendamenti 19

Deputeti **Nait Hasani** -me përkrahjen e Komisionit :

Në shtojcën II tek Objektet e Kishës Ortodokse Serbe fshihet pika 3 si vijon : Shkolla Ortodokse për Priftërinj e Shën Kirilit dhe Metodit (Shkolla e mesme ortodokse).

Kryetari **Nait Hasani** falënderoi pjesëmarrësit dhe i përshëndeti deri në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 14,15

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani